



Nr. 164 Prot.

Datë 24.01.2022

Shërbimi Gjyqësor i Shprehur
nr. 068/2016/16
Përbërës të
www.eshp.edu.al



Nr. 11 Prot.

Datë 13.01 2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

KOMISIONIERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
përfaqësuar nga Komisionieri, **Z. Robert GAJDA**

DHE

INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, “UNIVERSITETI
EUROPIANI I TIRANËS”

përfaqësuar nga Administratori, **Z. Tildi Çadri**

Tiranë, Janar 2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Institucioni i arsimit të lartë, “Universiteti European i Tiranës”, më poshtë të quajtura “palë”,

Në mbështetje të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Nisur nga dëshira për të vendosur lidhje institucionale bashkëpunimi në interes të të dyja palëve, me qëllim promovimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, rritjen e kapaciteteve të personelit akademik dhe studentëve.

Bashkëpunimin e ndërsjellë në realizimin e veprimtarisë në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, ranë dakord për sa vijon:

NENI 1 QËLLIMI

Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje, palët bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre dhe për të cilat shfaqin interes të përbashkët. Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin mes Institucionit të arsimit të lartë, “Universiteti European i Tiranës”, dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në funksion të rritjes së ndërveprimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të palëve duke patur në fokus fenomenin e diskriminimit në realitetin shqiptar. Kjo marrëveshje do të ketë për qëllim rritjen e komunikimit dhe të shkëmbimit të eksperiencës ndërmjet stafit të dy institucioneve, studentëve, informacioneve si dhe realizimin e studimeve të përbashkëta për qartësimin e procedurave, kompetencave, hetimit administrativ dhe aspekteve të tjera të rëndësishme të parashikura nga Ligji nr.102201 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ndryshuar.

NENI 2 PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Kjo marrëveshje lidhet për të lehtësuar marrëdhëniet ndër-institucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me synim komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.



2. Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëveshje nuk çenojnë apo ndikojnë tek të drejtat dhe detyrimet që i burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.
3. Palët njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit, personelit akademik dhe studentëve, bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, në bashkërendim me ligjin, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të tyre.

NENI 3 OBJEKTI

Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje, palët bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat e veprimtarisë së tyre dhe për të cilat shfaqin interes të përbashkët.

NENI 4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të shkëmbejnë personel akademik për dhënie leksionesh të veçanta në lëndët apo modulet që ato do t'i gjykojnë me interes.
2. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese dhe trajnimeve (zhvillimi i leksioneve të hapura me tematika të ndryshme, zhvillimin e simpoziumeve, seminareve dhe/ose konferencave të përbashkëta, etj.), me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimin e studentëve për çështjet me interes të përbashkët.
3. Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të shkëmbejnë botime akademike apo periodike.
4. Të dyja palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në kualifikimet e personelit akademik nëpërmjet organizimit të seminareve trajnuese apo udhëheqjes shkencore për përgatitje dhe mbrojtje mikrotezash, etj.
5. Personeli akademik i të dyja palëve, në varësi të interesit, do të marrin pjesë në veprimtari të përbashkëta studimore.
6. Të dyja palët do të nxisin pjesëmarrjen e personelit të tyre akademik në projekte të përbashkëta kërkimore e shkencore.
7. Të dyja palët do të informojnë njëra-tjetrën për organizimin e konferencave shkencore nga ana e tyre ose në bashkëpunim me fakultete apo institucione homologe, vendase ose të huaja dhe do të inkurajojnë pjesëmarrjen e personelit akademik në këto veprimtari.
8. Të dyja palët do të krijojnë mundësi e hapësira për botime shkencore në revistat e tyre reciproke të institucioneve nga personelit akademik.



9. Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të zhvillojnë aktivitete reciproke të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët.
10. Të dyja palët do të krijojnë mundësinë e përdorimit reciprok të bibliotekave për literaturë të paklasifikuar për pedagogët dhe studentët respektivë, si dhe të inkurajojnë përdorimin e teksteve mësimore në mënyrë të ndërsjellë.

NENI 5 KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

1. Palët për zbatimin e kësaj marrëveshjeje caktojnë nga një person kontakti/koordinator për secilin institucion.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për bashkëpunim.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e të dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

NENI 6 MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE DHE KONFIDENCIALITETI


Palët marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave apo informacioneve me të cilat janë vënë në dijeni gjatë bashkëpunimit të tyre. Ruajtja dhe përpunimi i informacionit të shkëmbyer do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 7 PRONËSIA INTELEKTUALE

Të gjitha pronat intelektuale (intervista, punime, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në pronësi të përbashkët e të dyja palëve.

NENI 8 KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

Kjo Marrëveshje nënshkruhet nga *Institucioni i arsimit të lartë, "Universiteti Europian i Tiranës"*, dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dhe është në fuqi për një afat kohor



të papërcaktuar. Marrëveshja mund të shfuqizohet, me kërkesën e njëres palë, pas njoftimit me shkrimin, ku parashtrihen edhe arsyet e shfuqizimit, të paktën 3 muaj datës së shfuqizimit.

NENI 9 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Në rast se linden mosmarrëveshje në zbatimin e kësaj Marrëveshje, palët marrin përsipër zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse kjo nuk është e mundur palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet tyre.

Marrëveshja mund të zgjidhet edhe me kërkesën e njëres palë, pas njoftimit paraprak me shkrim në një afat të arsyeshëm, që parashtron dhe arsyet e prishjes së marrëveshjes.

NENI 10 AMENDIME TË MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet pjesërisht ose tërësisht, vetëm me shkrim, nëse palët bien dakord bien dakord.

NENI 11 HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit ndërmjet palëve.

NENI 10 DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo Marrëveshje mund të përmirësohet në çdo kohë në dobi të punës e në reference të plotë të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konformë vullnetit të të dyja palëve, marrëveshja nënshkruhet nga secila palë.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në dy kopje origjinale, një për secilën palë.

**UNIVERSITETI EUROPIAN I
TIRANËS**

ADMINISTRATOR



**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

KOMISIONIER

ROBERT GAJDA

